



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 32/8 prot.

Tiranë, më 27.5. 2021

RELACION

Lënda: Mbi raportet e monitorimit për 4-mujorin e parë të vitit 2021

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.3.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, është kryer monitorimi i zbatimit të buxhetit për Institucionin e Komisionerëve Publikë për 4 mujorin e parë të vitit 2021. Zbatimi i këtij buxheti mbështetet në drejtimet kryesore të miratuara me vendimet e Mbledhjes së Komisionerëve, Grupit të Menaxhimit Strategjik si dhe bazuar në parimin e ekonomicitetit, efikasitetit dhe eficiencës në përdorimin e fondeve buxhetore. Në vijim paraqitet në mënyrë të përmbledhur, analiza e përdorimit të fondeve buxhetore për 4- mujorin e vitit 2021, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ata të planifikuar.

në mijë lekë

Emërtimi	Buxheti vjetor (plani)	Buxheti vjetor i rishikuar (plani)	Buxheti 4-mujor (plani)	Realizimi vjetor	Realizimi në %
Shpenzime korente	70,350	70,350	24,850	21,086	84.9%
Shpenzime kapitale	4,000	4,000	-	-	-
TOTALI	74,350	74,350	24,850	21,086	84.9%

Fondet buxhetore të miratuara në fillim të vitit 2021, prej 74,350 mijë lekë në shpenzime korente dhe shpenzime kapitale, siç është argumentuar dhe në komunikimet me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nuk plotësojnë kërkesat e institucionit për shpenzime personeli, në përputhje me dispozitat ligjore në fushën e pagave.

Ndërkohë fondet e miratuara në shpenzimet operative dhe shpenzimet kapitale tejkalojnë nevojat dhe kërkesën e institucionit, reflektuar këto dhe në detajimin mujor të këtyre artikujve buxhetorë si dhe në Regjistrin e Parashikimit të Prokurimeve Publike për vitin 2021.

Në muajin prill, me kërkesë të institucionit, janë rishpërndarë fondet buxhetore brenda shpenzimeve korente duke pakësuar shpenzimet operative dhe shtuar shpenzimet në paga dhe sigurime shoqërore, në vlerën 7,300 mijë lekë.

Performanca e realizimit të fondeve buxhetore për 4-mujorin e parë të vitit 2021 në krahasim me planin e periudhës, është në nivelin 84.9%. Performancën më të lartë të realizimit e kanë shpenzimet e personelit dhe pjesërisht shpenzimet operative. Në mënyrë analitike, performanca e realizimit të shpenzimeve për këtë periudhë, për Institucionin e Komisionerëve Publikë, paraqitet në vijim:

Realizimi i buxhetit sipas artikujve buxhetorë

në mijë lekë						
Artikulli	Emërtimi	Buxheti vjetor (plani)	Buxheti vjetor i rishikuar (plani)	Buxheti 4-mujor (plani)	Realizimi vjetor	Realizimi në %
600+601	Paga dhe sigurime	57,000	64,300	23,000	20,241	88 %
602+606	Shpenzime për mallra dhe shërbime, dhe fondi i veçantë	13,350	6,050	1,850	844	45.6 %
231	Shpenzime kapitale	4,000	4,000	0	0	0 %
	TOTALI	74,350	74,350	24,850	21,085	84.8%

1.Artikulli 600 dhe 601, “Shpenzime personeli”, buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit 2021 për këtë zë është 57,000 mijë lekë, buxhet i cili ashtu si dhe në vitet e tjera nuk mbulon nevojat e institucionit për të gjithë vitin, gjë që është reflektuar në detajimin mujor të buxhetit. Për këtë arsye është kërkuar rishpërndarja e fondeve nga shpenzimet operative në shpenzime për paga, i cili është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në muajin prill. Buxheti në paga dhe sigurime shoqërore pas rialokimit ka arritur në vlerën 64,300 mijë lekë. **Me gjithë transferimin e fondeve ende ka nevoja të paplotësuara në paga sipas kërkesës së argumentuar në projektbuxhet, në vlerën rreth 2,000 mijë lekë.**

Buxheti i rishikuar pas transferimit, parashikohet të mbulojë të gjithë detyrimet ligjore për pagat dhe shtesat mbi pagë sipas përcaktimeve në ligjin nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar

të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, dhe Vendimin e Kuvendit nr.102/2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin e Kuvendit nr. 94/2017”, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikësi, ndryshimet në përllogaritjet si rezultat i rritjes së pagës minimale në shkallë vendi si dhe shpenzimet në paga për 2 punonjësit me kontratë të përkohshme, miratuar me VKM. nr. 1151 datë 24.12.2020.

Performanca e realizimit të planit për 4-mujorin e vitit 2021 është në nivelin 88% për shkak të realizimit të transferimit gjatë muajin prill ndërkohë që pagesat e shtesës për vështirësi për njësinë e shërbimit ligjor, sipas detyrimit ligjor përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 29 të Ligjit 84/2016, janë kryer në muajin maj.

2. Artikulli 602, “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera”, buxheti i miratuar në fillim të vitit në këtë artikull për vitin 2021 është 13,200 mijë lekë, buxhet i cili siç u theksua më lart, e tejkalon kërkesën e institucionit, reflektuar kjo në projektbuxhet, detajimin e buxhetit si dhe në Regjistrin e Parashikimit të Prokurimeve Publike, duke lënë 5,800 mijë lekë fond të pashpërndarë dhe të paplanifikuar për tu përdorur.

Për këtë arsye në muajin prill buxheti në shpenzime operative u pakësua me 7,300 mijë lekë, duke reduktuar pothuajse të gjitha shpenzimet e planifikuara për udhëtime dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare, një pjesë të shpenzimeve telefonike si dhe të gjithë fondin e pashpërndarë, i cili theksojmë, nuk ishte përfshirë për tu prokuruar që në fillim të vitit. Në total pas rishpërndarjes, buxheti prej 5,900 mijë lekë, vlerësojmë se do të mbulojë nevojat e institucionit gjatë vitit, për mallra dhe shërbime.

Performanca e realizimit të buxhetit në “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera”, në bazë të analizës krahasimore plan-fakt për 4-mujorin e parë të vitit 2021, është në nivelin 45.6%. Gjatë kësaj periudhe janë kryer disa procedura prokurimi, blerje me vlerë të vogël, për shërbime dezinfektimi, si dhe me procedura të thjeshtuara blerje: kanceleri, shpenzime larje automjeti, mirëmbajtje pajisje teknike, elektrike etj. Gjithashtu janë kryer shpenzime nga buxheti dhe janë lidhur kontrata për parkim automjeti, telefoni celulare, si dhe shpenzimet e zakonshme shpenzime për energji, ujë, postë, taksat e bashkisë etj.

Theksojmë se me miratimin e ligjit për fiskalizimin që nga 1 janari i vitit 2021 janë ngadalësuar procedurat për blerje mallra dhe shërbime për shkak se shumë furnitorë nuk lëshonin faturën e fiskalizuar. Po kështu ndryshimet në legjislacionin e prokurimit publik të pashoqëruara me aktet nënligjore me rregullat e reja të prokurimit ka shkaktuar vonesa, paqartësi dhe shtyrjen e disa procedurave të prokurimit të planifikuara në këtë 4-mujor. Në muajin maj ka vijuar dhe është finalizuar procedura për blerjen e materialeve të pastrimit dhe mbrojtjes personale si dhe procedura për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave etj.

Ndërkohë, një pjesë e shpenzimeve të planifikuara, për shkak të natyrës së tyre, nuk mund të realizoheshin në kushtet e kufizimit të lëvizjeve për shkak të pandemisë, si shpenzime udhëtimi e dieta dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare.

Këto fonde të papërdorura u pakësuan dhe sëbashku me fondin e pashpërndarë u transferuan në shpenzime personeli.

Analitikisht, shpenzimet operative janë realizuar si më poshtë:

në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	602	
		Plan	Fakt
1	Materiale e shpenzime zyre	674	47
2	Shërbime nga të tretë (energji, ujë, postë, telefon, parkim etj.)	798	732
3	Shpenzime transporti + udhëtimi	93	7
4	Shpenzime mirëmbajtje të zakonshme	115	12
5	Shpenzime të tjera speciale	20	17
	TOTALI	1,700	815

3. Artikulli 231, “Shpenzime kapitale”, buxheti i miratuar për këtë artikull për vitin 2021 është 4,000 mijë lekë. Gjatë këtij 4-mujori nuk ka pasur rishikime të tij, megjithëse ky fond tejkalon kërkesën e institucionit për sa i përket këtij zëri të buxhetit, paraqitur kjo në projektbuxhetin 2021-2023 si dhe në komunikimet me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detajimin e buxhetit për vitin 2021.

Kërkesa e institucionit në shpenzime kapitale është 1,000 mijë lekë të parashikuara për tu përdorur në 4 mujorin e dytë të vitit 2021 dhe si rezultat për këtë periudhë nuk kemi realizim të buxhetit në artikullin “Shpenzime kapitale”.

Në përfundim dëshirojmë t’ju risjellim në vëmendje që fondet e miratuara në shpenzime kapitale ashtu si dhe në shpenzime operative janë më të larta se nevojat buxhetore të institucionit, parashikuar në projektbuxhetin 2021-2023, ndërkohë që kemi nevojë përsëri për fonde shtesë në artikullin buxhetor “paga dhe sigurime shoqërore”. Për këtë problematikë ju kemi vënë në dijeni në vazhdimësi me relacionin e projektbuxhetit si dhe me shkresën e detajimit të buxhetit nr. 30/15prot., datë 28.12.2020.

Vlerësojmë gjithashtu se buxheti i 4-mujorit të parë të vitit 2021, është zbatuar në përputhje me dispozitat ligjore, dhe konform fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2021, duke synuar një performancë në rritje të realizimit të fondeve buxhetore në të gjithë zërat e shpenzimeve si dhe plotësimin e nevojave të domosdoshme për ecurinë e aktivitetit institucional.

Nëpunës Zbatues

Adelina Kastrati



Nëpunës Autorizues


Alketa Çeli

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit		Komisioneret Publike				Kodi i Grupit		63	
Programet		Shpenzimet e Institucionit							
Titulli	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	(2) PBA Viti 2021	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes 4 mujore /progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca	
0001	Programi 03360	63,387	75,800	74,350	74,350	24,850	21,086	-3,764	
Totali i Shpenzimeve te Institucionit		63,387	75,800	74,350	74,350	24,850	21,086	-3,764	
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit					-				
Totali		63,387	75,800	74,350	74,350	24,850	21,086	-3,764	

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	27.5.2021		Data	27.5.2021




ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit	Komisionerët Publikë						Kodi i Grupit	63
Programi	Veprimtaria e Komisionerit Publik						Kodi i Programit	03360
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	(2) PBA Plan 2021	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar viti korrent 2021	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes 4 mujore /progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	54,495	59,700	51,500	58,200	20,400	18,145	-2,255
601	Sigurime Shoqërore	5,902	6,100	5,500	6,100	2,600	2,096	-504
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	2,371	9,000	13,200	5,900	1,700	815	-885
603	Subvencione							0
604	Transferta Korente të Brendshme							0
605	Transferta Korente të Huaja							0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	40		150	150	150	30	-120
Nen -Totali	Shpenzime Korrente	62,808	74,800	70,350	70,350	24,850	21,086	-3,764
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara	579	1,000	4,000	4,000	0	0	0
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	579	1,000	4,000	4,000	0	0	0
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara							0
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0	0
Totali	Shpenzime Kapitale	579	1,000	4,000	4,000	0	0	0
	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti						0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		63,387	75,800	74,350	74,350	24,850	21,086	-3,764


Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	27.5.2021		Data	27.5.2021




ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treqesve te performances/produkteve te programit"

Emri I Grupit	Komisioneret Publike	63
Programi	Veprimtaria e Komisionerit Publik	3360

Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njesia matese	Sasia Faktike (sipas vitit 2020)	Shpenzimet (sipas vitit 2020)	I			II			III			IV			Luhatjet ne Koston per Njesi			Komente
					Kosto per Njesi (sipas vitit 2020)	Sasia (sipas planit te vitit 2021)	Shpenzimet (sipas planit te vitit 2021)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit 2021)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit 2021)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit 2021)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit 2021)	Sasia Faktike per 4 mujorin e vitit 2021	Shpenzimet Faktike per 4 mujorin e vitit 2021	Kosto per Njesi per 4 mujorin e vitit 2021	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III			
Produkti 1	Numer Cheshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	nr. Cheshtjesh	103	62,808	610	140	70,350	503	140	70,350	503	47	21,086	449	-26%	-11%	-11%			
Produkti 2	Pajisje komp/mobile/pajisje zyre	sete pune	5	579	116	9	4,000	444	9	4,000	444	0	0	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!			
Totalt				63,387	726	149	74,350	947	149	74,350	947	47	21,086	#DIV/0!						

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati
	Firma	
	Data	27.5.2021

Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma	
	Data	27.5.2021



ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikës se programit"

Periudha e Raportimit: 4 mujori 2021

Kodi i Programit	3360	Emertimi i programit:						Komen
Qellimi 1	Procesi i Rivleresimit te gjyqtareve dhe prokuroreve ne Republiken e Shqiperise ka per qellim garantimin e e funksionimit te shtetit te se drejtes, pavaresine e sistemit te drejtesise si dhe rikthimin e besimit te publikut tek institucionet e ketij sistemi	Veprimtaria e komisionerit Publik						
Objektivat e politikës:		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Niveli faktik i vitit 2020	Niveli i planifikuar ne vitin 2021	Niveli i rishikuar per 4 mujorin e vitit 2021	Niveli faktik per 4 mujorin e vitit 2021	% e realizimit te Treguesit te Performances/Produktit
Objektivi 1.1	Mbrojtja e interesit publik gjate kryerjes se procesit te rivleresimit, respektimi i parimit te paanesise dhe pavaresise, procesit te rregullt ligjor, transparencës dhe frymes se bashkepunimit ndermjet dy komisionereve publike, Operacionit Nderkombetar te Monitorimit dhe institucioneve te tjera."							
	Numer Çeshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	A	Shqyrtim i vendimeve te njoftuara nga KPK	103	140	140	47	34%


Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizus	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	27.5.2021		Data	27.5.2021



ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"

Projektet me financim te brendshëm (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti i Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2021	Realizimi Progrosiv nga fillimi i vitit 2021	Realizimi për periudhën e raportimit vjetor	Realizimi Progrosiv nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
M630002	Pajisje dhe mobilje zyre	2,000	2021	2021		2,000				
M630013	Pajisje kompjuterike	2,000				2,000				
TOTALI		4,000			-	4,000	-	-	-	Jane fonde qe tejkalojne kerkesen e intituicionit. Fondi i kerkuar prej 1,000 leke ne shpenzime kapitale eshte planifikuar ne 4 mujorin e 2-te

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastri	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizus	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	27.5.2021		Data	27.5.2021

